
LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJI

RAPORTI TREMUJOR 7



TAKIMI I KATËRT I BORDIT UDHËHEQËS: REZULTATE KONKRETE DHE PARTNERITETE TË FORTA

PAS GATI 13 VITESH BETEJË LIGJORE, NJË VAJZË MË NË FUND MERR ÇERTIFIKATËN E LINDJES

INTERVISTË ME NIK LOGOFETOV, EKSPERT NË KRIPTOVALUTA DHE MASHTRIME ONLINE

FORUMI PJESËMARRËS PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT MES INSTITUCIONEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PARLAMENTIT

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

MAJ 2025

MOHIM PËRGJEGJËSIE:
KY RAPORT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI PËR TË DREJTAT THEMELORE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Në këtë botim bëhet sërish përmbledhje e disa arritjeve të jashtëzakonshme në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" në Maqedoninë e Veriut. Gjatë muajve të fundit, janë bërë hapa të rëndësishëm bashkëpunues në drejtim të reformave të gjyqësorit, luftës kundër krimit të organizuar, forcimit të mekanizmave kundër korrupsionit dhe promovimit të të drejtave themelore.

Projekti ka mbështetur me sukses Ministrinë e Drejtësisë në përgatitjen e propozim ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe në forcimin e procedurave disiplinore për përgjegjësinë gjyqësore. U finalizua projektligji për Prokurorinë Publike, ndërkohë që Ligji për Këshillin e Prokurorëve është në përpilim e sipër.

Tek aktivitetet për të forcuar mekanizmat kundër korrupsionit bën pjesë edhe zhvillimi i Sistemit për Menaxhimin me Burimet Njerëzore për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), trajnime të rëndësishme, si dhe përgatitjen e Strategjisë së re Kombëtare Kundër Korrupsionit, siç theksohet edhe në intervistën me udhëheqësin e komponentit tonë, Roman Prah.

Një nga historitë më të prekshme të suksesit që theksohen në këtë botim është rasti i një vajze që, pas gati 13 vitesh beteje ligjore, më në fund mori çertifikatën e lindjes.

PARATHËNIE

E lindur pa u njohur nga sistemi, ajo ishte e padukshme për autoritetet dhe e privuar nga të drejtat themelore si shërbimi shëndetësor. Avokati i Popullit, me mbështetje direkte nga ekspertët e angazhuar në projektin tonë, e zgjidhi këtë rast, duke mundësuar regjistrimin e saj në regjistrin civil dhe duke I dhënë kështu qasje në të drejtat që i takojnë në vend. Ishte një rrugë e gjatë, dhe duke e shoqëruar rastin, u bë e qartë se zbatimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës i duhet rishqyrtim i rëndësishëm, në mënyrë që të mos vazhdojë të ndikojë në jetën e përditshme të të miturve përmes pengesave burokratike dhe procedurave që duken pa fund.

Në Forumin tonë për të Drejtat e Njeriut, tema e bashkëpunimit midis Parlamentit dhe institucioneve të të drejtave të njeriut çoi në diskutime të frytshme dhe rezultate konkrete.

Një tjetër fushë e rëndësishme e trajtuar në këtë raport është ajo e zhvillimit të krimit në kriptomonedha. Me rritjen e përdorimit të kriptomonedhave, rriten edhe rreziqet që lidhen me mashtrimet online dhe krimin digjital. Në intervistën interesante me Nik Logofetov, ekspert ndërkombëtar në krimin e lidhur me kriptomonedhat, diskutohen kërcënimet me të cilat përballemi në vitin 2025, kufizimet e rregulloreve aktuale dhe realitetet e hetimeve digjitale. Pikëpamjet e Nikut ofrojnë një perspektivë të qartë mbi sfidat dhe mundësitë në luftën kundër krimit të kriptomonedhave.

Më 3 prill, u mbajt takimi i katërt i Bordit Udhëheqës të projektit, ku u pa se të gjitha arritjet pasqyrojnë partneritetet e forta dhe përpjekjet bashkëpunuese të ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas, partnerëve të konsorciumit dhe institucioneve përfituese. Mbështetja e vazhdueshme e Delegacionit të Bashkimit Evropian ka qenë thelbësore në avancimin e këtyre përpjekjeve.

Ndërsa vazhdojmë përpara, le të ndërtojmë mbi këto arritje dhe të synojmë një shoqëri më të drejtë dhe transparente. Rruga përpara mund të jetë sfiduese, por me përpjekje të përbashkëta, do të arrijmë qëllimet tona dhe do të kemi një ndikim të qëndrueshëm në sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut.

Shijoni lajmet e mira!

Diter Shindlauer



JU PREZANTOJMË:

TAKIMI I KATËRT I BORDIT UDHËHEQËS

Takimi i katërt i Bordit Udhëheqës u mbajt më 3 prill 2025 dhe në të u shënuan rezultate konkrete dhe partneritete të forta. Në këtë takim fokusi ishte tek prezantimi i rezultateve nga gushti 2024 deri në shkurt 2025 dhe hapat që planifikohen më tej.

VAJZA 13-VJEÇARE MERR ÇERTIFIKATËN E LINDJES

Pas gati 13 vitesh beteje ligjore, një vajzë më në fund merr çertifikatën e lindjes. Rasti u raportua tek Avokatin e Popullit (AP) për një zgjidhje më të shpejtë. Me mbështetje direkte nga ekspertët e angazhuar në projekt, rasti u zgjidh.

FORUMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Deputetët dhe përfaqësuesit e institucioneve përfituese të Projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" u takuan në Forumin Pjesëmarrës për Forcimin e Bashkëpunimit midis Institucioneve të të Drejtave të Njeriut dhe Parlamentit.

Të flasim pak për...

- Rezultate konkrete dhe partneritete të forta shënohen në Takimin e Katërt të Bordit Udhëheqës
- Pas 13 vitesh si e padukshme për sistemin, një vajzë më në fund merr çertifikatën e lindjes
- Të kuptuarit e krimit në kriptomonedha: Intervistë me Nik Logofetov, ekspert për kriptovaluta dhe mashtrime online
- Projektligji për Prokurorinë Publike finalizohet dhe vazhdojnë angazhimet për Ligjin e Këshillit të Prokurorëve
- Forumi Pjesëmarrës për Forcimin e Bashkëpunimit midis Institucioneve të të Drejtave të Njeriut dhe Parlamentit
- Tryezat e rrumbullakëta për mbikëqyrjen e prokurorëve dhe vlerësimin e performancës
- Projekti "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" ndihmoi Ministrinë e Drejtësisë në përgatitjen e propozimeve dhe ndryshimeve për Ligjin e Këshillit Gjyqësor
- Forcimi i procedurave disiplinore për përgjegjësinë gjyqësore në Maqedoninë e Veriut

Rezultate konkrete dhe partneritete të forta shënojnë Takimin e Katërt të Bordit Udhëheqës

Projekti "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" mbajti takimin e katërt të Bordit Udhëheqës më 3 prill 2025, në ambientet e **Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK)**. Takimi u përqendrua në prezantimin e rezultateve të projektit nga gushti 2024 deri në shkurt 2025 dhe në përcaktimin e hapave të mëtejshëm.

Marzia Palota, përfaqësuese e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut (DEU), theksoi rëndësinë e përpjekjeve të përbashkëta dhe rolin e tyre thelbësor në implementimin e reformave që lidhen me sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Ajo inkurajoi institucionet përfituese të vazhdojnë të shfrytëzojnë në maksimum mbështetjen dhe burimet e ofruara nga Projekti.

Agnes Taibl, Drejtore e Projektit nga Instituti Ludvig Bolcman për të Drejtat Themelore dhe të Drejtat e Njeriut, shprehu mirënjohjen për përpjekjet e të gjithë anëtarëve të ekipit të projektit dhe institucioneve përfituese, dhe i uroi mirëseardhjen Roman Prahut si udhëheqës i ri i Komponentit 3. Ajo vlerësoi rëndësinë e angazhimit të përbashkët të ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas, bashkëpunimin e fortë midis partnerëve të konsorciumit—CILC, Ministrisë së Brendshme të Sllovenisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, Administratës Publike dhe Transformimit Digjital të Kroacisë—dhe mbështetjen e vazhdueshme të Delegacionit të Bashkimit Evropian (DEU).

Takimi u moderua nga **Diter Shindlauer**, Udhëheqës i Ekipit të Projektit, i cili reflektoi mbi arritjet kyçe deri më tani dhe paraqiti vizionin për periudhën e ardhshme. “Kemi arritur shumë, por ka akoma shumë për të bërë. Besoj fort se qytetarët e këtij vendi meritojnë të shohin rezultate të prekshme dhe përmirësime,” tha ai.



Udhëheqësit e Komponentëve prezantuan arritjet kyçe nga periudha e raportimit, duke theksuar rolin e projektit në avancimin e reformës gjyqësore, luftën kundër krimit të organizuar, forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit dhe promovimin e të drejtave themelore.

Nga gushti 2024 deri në shkurt 2025, projekti përparuar mjaft në të katër komponentët. **Komponenti 1** kontribuoi në reformën gjyqësore duke organizuar konsultime në nivel kombëtar mbi Ligjin për Këshillin Gjyqësor, ku u bënë bashkëmë shumë se 100 gjyqtarë, u ofruan trajnime të specializuara IT për stafin e gjykatave dhe prokurorive, dhe u mbështet zbatimi i Strategjisë Gjyqësore 2024–2028. **Komponenti 2** forcoi përpjekjet për të luftuar krimin e organizuar përmes ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve kundër mashtrimeve online, hetimet financiare dhe korrupsionin, dhe duke hartuar strategji kombëtare për krimin e organizuar dhe krimin kibernetik.



Komponenti 3 u fokusua në forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit, përfshirë këtu zhvillimin e Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për KShPK-në, ofrimin e trajnimeve kyçe dhe përgatitjen e Strategjisë së re Kombëtare Kundër Korrupsionit. **Komponenti 4** bëri përparime të rëndësishme në promovimin e të drejtave themelore dhe alternativave ndaj paraburgimit. Më shumë se 183,000 persona u përfshinë përmes fushatave të ndërgjegjësimit, u finalizua Plani Kombëtar i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve dhe mandatet e institucioneve kyçe u përforcuan përmes ndërtimit të kapaciteteve, partneriteteve strategjike dhe forumeve ndërinstitucionale. Gjithashtu, u prezantua dhe u zbatua një fushatë kundër dhunës mes bashkëmoshatarëve.

Përfaqësuesit e institucioneve partnere nga Republika e Maqedonisë së Veriut shprehën mirënjohjen e tyre për mbështetjen e projektit dhe kontributin e tij të vazhdueshëm në forcimin e sundimit të ligjit.

Në këtë takim, ku morën pjesë 48 përfaqësues nga Delegacioni i BE-së, partnerët e konsorciumit, institucionet përfituese dhe ekspertët, u theksuan përpjekjet e përbashkëta drejt ndërtimit të një shoqërie më të drejtë dhe transparente në Maqedoninë e Veriut.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Pas gati 13 vitesh betejë ligjore, një vajzë më në fund merr certifikatën e lindjes

Ajo duhej të kishte pasur të njëjtat të drejta si çdo fëmijë tjetër në vendin tonë, që nga lindja e saj në vitin 2012. Në vend që t'i kishte ato, atë nuk e njihte sistemi. Më në fund, pas gati 13 vitesh përpjekjesh ligjore, ajo siguroi një certifikatë lindjeje, duke e vërtetuar të drejtën e saj themelore për të ekzistuar përpara autoriteteve.

Gjithçka filloi në qershor të vitit 2024, kur rasti u paraqit pranë Avokatit të Popullit për një zgjidhje më të shpejtë. Me mbështetjen e drejtpërdrejtë nga ekspertët e angazhuar në projektin "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", Avokati i Popullit e zgjidhi çështjen.

Gjatë konferencës për shtyp organizuar nga institucioni, Gjulizar Sulejman, gjyshja e vajzës, nuk e fshehu lumturinë që mbesa e saj u regjistrua më në fund në Regjistrin Civil.



> "Ajo nuk kishte certifikatë lindjeje tashmë 12 vjet. Pas kaq shumë kohe, falë Avokatit të Popullit, morëm certifikatën e lindjes për mbesën time. Jam shumë e lumtur dhe mirënjohëse për ndihmën," tha ajo.

Merima Fizulai, drejtuese e qendrës ditore në Shuto Orizar, që vajza kishte frekuentuar, theksoi:

> "Pas 12 vitesh, vajza më në fund ka qasje tek gjitha të drejtat që i garanton shteti. Më parë, ajo nuk kishte qasje në kujdesin shëndetësor dhe në të drejta të tjera themelore."



Nëna e vajzës kishte vite që përpiqej të rregullonte dokumentacionin, por fatkeqësisht kishte ngecur në labirint burokratik. Në vend të një zgjidhjeje të thjeshtë, zyrtarët i kërkonin dokumente shtesë, duke e ndërlikuar më tej procedurën.

Zyra e Avokatit të Popullit, e cila thekson se ky nuk është rast i izoluar, përfundimisht ofroi ndihmë. Rreth 400 "persona të padukshëm" kanë aplikuar për certifikatë lindjeje që nga viti 2021, pas ndryshimeve ligjore, por procedura mbetet e vështirë. Meqenëse lufta për identitet vazhdon për qindra të tjerë, Avokati i Popullit, Naser Ziberi, deklaroi se do të propozojë që Zyra e Regjistrit Civil t'i zgjidhë këto raste më shpejt.



Të kuptuarit e Krimit me Kriptovaluta: Një Intervistë me Nik Logofetov, Ekspert në Kriptovaluta dhe Mashtrime Online

Me përhapjen gjithnjë e më të madhe të përdorimit të kriptovalutave, janë shtuar edhe rreziqet që lidhen me mashtrimet online dhe krimin digjital. Në këtë intervistë, bisedojmë me **Nik Logofetov**, ekspert ndërkombëtar për krimet që lidhen me kriptovalutat, rreth fushës të mashtrimeve me kripto që është në zhvillim e sipër, kufizimeve të rregulloreve aktuale dhe keqkuptimeve më të zakonshme që lidhen me teknologjinë blockchain dhe anonimitetin. Duke u bazuar në përvojën e tij të gjerë dhe bashkëpunimet ndërkufitare, Nik ofron një perspektivë të qartë mbi kërcënimet me të cilat përballemi në vitin 2025 dhe realitetet e hetimeve digjitale në një mjedis që ndryshon me shpejtësi.



Nik, ju jeni ekspert në fushën e kriptovalutave dhe mashtrimeve digjitale. Cili është roli juaj në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" dhe cilat janë objektivat tuaja në këtë angazhim?

Në këtë project jam i angazhuar si ekspert që mbështet policinë në Maqedoninë e Veriut, konkretisht njësinë për mashtrime digjitale, për të forcuar kapacitetin e tyre në hetimin e krimeve që lidhen me kriptovalutat. Projekti zgjat deri në vitin 2026, por qëllimi ynë është të arrijmë përparim të shpejtë deri në fund të vitit 2025.

Po nisim nga ajo që unë do ta quaja niveli 0 sa i përket kapacitetit hetimor në fushën e kriptos dhe synojmë të arrijmë nivelin 2 në shkallën ndërkombëtare nga 0 deri në 5, të përcaktuar nga Europol dhe Interpol. Niveli 2 nënkupton aftësi për të punuar me disa kriptovaluta dhe rrjete të ndryshme, si dhe për të zhvilluar hetime në mënyrë të pavarur, përveç rasteve kur duhet mbështetje ndërkombëtare e specializuar.

Si filloi bashkëpunimi juaj me autoritetet në Maqedoninë e Veriut?

Kontakti i parë ishte mjaft i drejtpërdrejtë dhe ndodhi përmes projektit. Pastaj, rreth dy ose tre muaj më vonë, drejtuesit e policisë së Maqedonisë erdhën për një vizitë zyrtare në Sllloveni. Gjatë asaj vizite, patëm diskutime më të thelluara dhe ata shprehën qartë nevojat e tyre. Unë tashmë kisha qenë në komunikim me kolegë maqedonas. Zbuluam raste të përbashkëta që përfshinin të njëjtët autorë dhe metoda në Sllloveni dhe Maqedoninë e Veriut. Maqedonia kishte blerë gjithashtu një mjet tjetër hetimor nga ne, dhe nisëm të bashkojmë kërkimet dhe informacionin për të arritur rezultate më efektive.

Duke marrë parasysh mungesën e rregulloreve në Ballkanin Perëndimor krahasuar me kuadrin MiCA të BE-së, a pritet që rregullore të ngjashme të aplikohen edhe në rajon?

MiCA sapo është zbatuar në BE, por ajo mbulon vetëm disa aspekte të këmbimeve të kriptovalutave. Priten edhe dy rregullore të tjera – njëra prej tyre quhet Digital Europe. Së bashku, ato do të krijojnë një kornizë të plotë rregullatore për kriptovalutat në BE. Me kalimin e kohës, është e mundur që politika të ngjashme të miratohen ose të përshtaten edhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Sa përqind e aktivitetit me kriptovaluta ka natyrë kriminele, krahasuar me sistemet tradicionale financiare?

Sipas të dhënave nga Chainalysis, shuma ditore e transaksioneve me kriptovaluta varion nga 100 deri në 120 miliardë dollarë. Nga kjo, rreth 30 deri në 35 miliardë dollarë në vit lidhen me aktivitete kriminele – një përqindje relativisht e vogël. Kapitali aktual i tregut për të gjitha kriptovalutat ishte rreth 3.25 trilionë euro para disa muajve, megjithëse kjo shifër mund të ndryshojë ndjeshëm për shkak të luhatjeve të tregut. Për shembull, është provuar që transaksione me vlerë prej rreth 850 milionë eurosh kanë qenë mashtrime –një shifër jo e vogël, por gjithsesi jo dërrmuese.

Shumë njerëz besojnë se transaksionet me kriptovaluta janë të paidentifikueshme. Sa i saktë është ky perceptim?

Ky është kryesisht një mit. Shumica dërrmuese — rreth 95% — e transaksioneve me kriptovaluta janë të gjurmueshme. Blockchain-et janë regjistra publikë, dhe edhepse disa platforma kërkojnë mjete specifike ose qasje përmes rrjetit, informacioni nuk është i fshehur.

Ekzistojnë kriptovaluta për privatësi si Monero, që përdoren në tregje të paligjshme dhe janë qëllimisht të paidentifikueshme, por ato përbëjnë një pjesë shumë të vogël. Edhe kontratat inteligjente të dizajnuara për anonimitet janë të dukshme në blockchain dhe mund të analizohen

Cilat janë rreziqet më të mëdha të krimeve që lidhen me kriptovalutat për vitin 2025?

Parashikohet një rritje e mashtrimeve tregtare, skemave të investimeve mashtruese, skemave piramidale (Ponzi) dhe sulmeve ndaj sistemeve të informacionit. Shumica e mashtrimeve ende fillojnë me kontakt të drejtpërdrejtë — mashtruesit telefonojnë viktimat, fitojnë besimin e tyre dhe më pas i bindin të investojnë me premtime për fitime të mëdha. Këto trende janë shumë të pranishme në Slloveni dhe pritet të pasqyrohen edhe në rajon.

A janë gjithmonë kriminelët një hap përpara, apo ka gjithmonë rregullore që arrijnë t'iu vihen pas?

Fatkeqësisht, teknologjia zhvillohet aq shpejt sa hetuesit shpesh janë një hap pas. Nuk mund të parashikosh çdo metodë të re që do të përdorin kriminelët. Edhepse mund të parashikojmë disa trende, të jesh gjithmonë një hap përpara është thuajse e pamundur.

A mund të ndihmojë inteligjenca artificiale (IA) për ta zvogëluar këtë zbrazëtirë?

IA mund të ndihmojë, por përdorimi i saj aktualisht është i kufizuar për shkak të kompleksitetit dhe shkallës së madhe të të dhënave që përfshihen. Disa mjete, si TRM dhe Reactor i Chainalysis (dikur i quajtur Genesis), përdorin elementë të IA për të gjurmuar rrugët mes portofolëve dhe këmbimoreve. Por në fund të fundit, është ende analisti ai që duhet ta interpretojë të dhënat dhe të marrë vendimet hetimore.

A mendoni se krimi i bazuar në kriptovaluta do të bëhet ndonjëherë pothuajse i pamundur?

Jo plotësisht. BE-ja po punon për rregullore më të forta dhe ka spekulime se ligjet e ardhshme mund të ndalojnë disa aktivitete të caktuara me kripto—si minimi ose tregtimi i pakufizuar. Kina tashmë i ka ndaluar këto. Komisioni Evropian ka fuqinë ligjore të bëjë të njëjtën gjë përmes MiCA apo rregulloreve të ardhshme.

Duke qenë kaq afër zhvillimit të kësaj fushe, a e besoni ju personalisht kripton? A investoni në të?

Jo, nuk kam asnjë kriptovalutë. E konsideroj veten të aftë financiarisht dhe mbështetem te një këshilltar financiar që punon me individë me pasuri të lartë. Asnjë prej tyre nuk investon në kripto për shkak të paqëndrueshmërisë dhe mungesës së mekanizmave mbrojtës. Në bankat tradicionale të BE-së, për shembull, depozitat deri në 100,000 € janë të garantuara edhe nëse banka falimenton. Kripto nuk ofron një siguri të tillë, as për të ashtuquajturat "stablecoins" që lidhen me monedha fiat apo me ar.

Nëse dikush këmbëngul të provojë,rekomandoj që të caktojë një shumë fikse mujore — për shembull 100 deri në 300 euro të të ardhurave të disponueshme — dhe të investohet për një periudhë 6-mujore. Më pas, prisni edhe 6 muaj ose një vit dhe vlerësoni rezultatet. Nëse jeni në fitim, mund të jetë e përshtatshme për ju. Nëse jeni në humbje, ndoshta nuk është.



Projektligji për Prokurorinë Publike finalizohet, ndërsa fillon puna për Ligjin mbi Këshillin e Prokurorëve Publikë

Procesi i hartimit dhe miratimit të Ligjit të ri për Prokurorinë Publike është një moment i rëndësishëm në kuadër të Agjendës së Reformës, me afat të përcaktuar deri në dhjetor 2025. Si pjesë themelore e sistemit gjyqësor, ky ligj klasifikohet si "ligj sistemik" dhe kërkon shumicë prej dy të tretash në Kuvend për miratim — po kjo shumicë duhet edhe për ndryshime kushtetuese. Rëndësia e tij qëndron në rregullimin e strukturës dhe funksionimit të përgjithshëm të sistemit të prokurorisë publike, me ndikim të gjerë në sektorin e të drejtës penale dhe standardet e mbrojtjes ligjore.

Duke e njohur rëndësinë e harmonizimit të ligjit me acqui-në e BE-së, standardet evropiane dhe opinionin e Komisionit të Venecias, projekti ofroi mbështetje të konsiderueshme gjatë gjithë procesit të hartimit. Ekspertët e projektit morën pjesë në të gjitha seancat e grupit punues dhe paraqitën raporte që trajtonin aspektet kyçe të kuadrit të prokurorisë publike, përfshirë mbikëqyrjen, vlerësimin e performancës, procedurat disiplinore dhe pavarësinë buxhetore. Këto raporte ofruan vlerësim të detajuar të kuadrit ligjor ekzistues, identifikuan sfidat sistemike dhe paraqitën rekomandime konkrete në përputhje me praktikat më të mira evropiane.



Mbështetja shtesë për përgatitjen e Ligjit për Prokurorinë Publike, Projekti do të vazhdojë për të siguruar ndihmë në ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorisë së Lartë. Ова е конзистентност низ gjithë institucionalja kornizë që e rregullon punën në prokurorinë publike. Procesot e zvogëlimit të këtyre ligjeve shënojnë një hap përpara, por kjo është vetëm fillimi.

Testi i vërtetë i suksesit qëndron në miratimin dhe zbatimin e tyre. Projekti mbetet i përkushtuar për të mbështetur institucionet kombëtare në këtë fazë të ardhshme, duke siguruar që reformat ligjore të përkthehen në mënyrë efektive në praktikë dhe që sistemi i prokurorisë publike të jetë më i pavarur, efikas dhe në përputhje me vlerat evropiane.

Forumi Pjesëmarrës për Forcimin e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve për të Drejtat e Njeriut dhe Parlamentit

Më 9 prill 2025, deputetë të Kuvendit dhe përfaqësues të institucioneve përfituese të projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit" u mblodhën në Forumin Pjesëmarrës për Forcimin e Bashkëpunimit ndërmjet Institucioneve për të Drejtat e Njeriut dhe Parlamentit. Në këtë forum që u mbajt në Klubin e Deputetëve në Shkup u krijua hapësirë për reflektim mbi sfidat aktuale dhe për identifikim të mënyrave konkrete për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut përmes bashkëpunimit më të ngushtë ndërinstitucional.

Pjesëmarrësit diskutuan se si mund të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet parlamentit dhe institucioneve për të drejtat e njeriut për të siguruar një mbikëqyrje më efektive, kuadër ligjor më i fortë dhe mbrojtje më e mirë e të drejtave të qytetarëve. Kjo ngjarje mundësoi shkëmbim joformal dhe rrjetëzim ndërmjet aktorëve kyç, me një fokus të qartë në gjenerimin e ideve të zbatueshme për bashkëpunim të ardhshëm.

Pjesëmarrësit vlerësuan veçanërisht larminë e perspektivave të përfaqësuara, atmosferën e hapur dhe respektuese, si dhe mundësinë për dialog të thelluar përtej kufijve institucionalë. Rezultatet e diskutimeve do të përfshihen në një raport për BE-në, duke kontribuar në përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.



Përmbledhje: Si të forcohet puna parlamentare për të drejtat e njeriut

- **Themeloni komisione dhe nënkomisione për të drejtat e njeriut**, duke siguruar një strukturë funksionale dhe efikase.
- **Publikoni dhe shpërndani raporte mbi të drejtat e njeriut,** për të rritur transparencën dhe ndërgjegjësimin.
- **Forconi marrëdhëniet e jashtme me ekzekutivin, gjyqësorin dhe institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut,** për një qasje më të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse.
- **Bëni hetime për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe organizoni seanca publike me komunitetet e prekura**, për të dëgjuar zërin e qytetarëve dhe për të siguruar llogaridhënie.
- **Angazhohuni në trajnime dhe programe ngritjeje kapacitetesh mbi të drejtat e njeriut** (p.sh., nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare).
- **Krijoni kanale të qasshme** për qytetarët dhe shoqërinë civile që të paraqesin shqetësimet e tyre për të drejtat e njeriut drejtpërdrejt në parlament.
- **Promovoni debate të hapura,** konsultime dhe platforma digjitale për pjesëmarrje publike në diskutimet dhe legjislacionin për të drejtat e njeriut.
- **Siguroni që buxhetet** kombëtare të ndajnë fonde të mjaftueshme për institucionet e të drejtave të njeriut dhe programet e mbrojtjes.








Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Tryeza të Rrumbullakëta për Mbikëqyrjen dhe Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

Mbikëqyrja dhe vlerësimi i performancës janë dy procedura të ndryshme, por të ndërlidhura ngushtë me punën e përditshme të prokurorëve publikë. Për të trajtuar në mënyrë të duhur secilën fushë, u përgatitën dy raporte të veçanta dhe u organizuan tryeza të rrumbullakëta të dedikuara.
Në këto ngjarje morën pjesë përfaqësues nga Zyra e Prokurorit Publik, Këshilli i Prokurorëve Publikë, Shoqata e Prokurorëve Publikë, si dhe një profesor nga Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, i cili njëkohësisht është edhe kryetar i grupit punues të ngritur për hartimin e ndryshimeve në Ligjin për Prokurorinë Publike dhe Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë.

Në tryezën e rrumbullakët të dedikuar procedurave të mbikëqyrjes, projekti prezantoi **Raportin gjithëpërfshirës për Mbikëqyrjen**. Prezantimi nxiti një diskutim produktiv mes pjesëmarrësve mbi kuadrin ligjor ekzistues, ndryshimet e propozuara në projektligj për Prokurorinë Publike dhe praktikat aktuale të mbikëqyrjes. Ngjarja nxori në pah mospërputhjet ndërmjet ligjit ekzistues, aktit nënligjor përkatës dhe zbatimit praktik.

Një nga përfundimet kryesore të tryezës së rrumbullakët për mbikëqyrjen ishte njohja e nevojës urgjente për të ndryshuar aktin nënligjor që rregullon këtë procedurë, me qëllim që të harmonizohet me projektligjin për Prokurorinë Publike, madje edhe përpara miratimit zyrtar të ligjit. Gjithashtu, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e futjes së një modeli të standardizuar të mbikëqyrjes, për të siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të unifikuar në zbatim.

Ndërkohë, në tryezën e rrumbullakët të përqendruar në procedurën e vlerësimit të performancës, u theksua se vlerësimet e rregullta të performancës nuk janë zbatuar në praktikë për më shumë se 15 vjet.

Gjatë kësaj ngjarjeje u prezantua Raporti mbi Vlerësimin e Performancës, i cili ofroi një analizë të thelluar të standardeve të BE-së. Për të adresuar mungesën e një organizimi operacional për kryerjen e vlerësimeve, projekti prezantoi një analizë praktike dhe plan zbatimi, i cili do t'u dorëzohet Zyrës së Prokurorit Publik dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.

Kjo qasje proaktive synon të lehtësojë dhe përshpejtojë procesin e vlerësimit të performancës, në përputhje me afatet e përcaktuara në Ligjin për Prokurorinë Publike, duke kontribuar në një sistem më të përgjegjshëm dhe profesional të prokurorisë.



Projekti i BE-së për mbështetjen e sundimit të ligjit ndihmon Ministrinë e Drejtësisë në përgatitjen e ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Më 25 prill 2025, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut i dërgoi Komisionit të Venecias propozim ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor për mendim. Projekti "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" ofroi mbështetje aktive në këtë proces, i cili u ndërmor për të adresuar rekomandimet e Raportit të Misionit të Vlerësimit nga Kolegët Evropianë mbi funksionimin e Këshillit Gjyqësor.Projekti mbështeti grupin punues të caktuar nga Ministri i Drejtësisë për hartimin e ndryshimeve përmes organizimit të konsultimeve të gjera me gjyqtarët dhe opinionin ekspert, përgatitjes së analizave ligjore dhe kontributeve direkte në seancat e grupit punues.

Për të finalizuar ndryshimet, më 14 prill 2025, në Klubin e Deputetëve u organizua një punëtori njëditore, ku u rishqyrtua teksti i ligjit, u diskutuan çështjet e hapura dhe u përmbyllën propozim ndryshimet në këtë fazë.



Në një atmosferë pune produktive, grupi punues përgatiti draftin përfundimtar, i cili më pas u redaktua dhe përkthye tekstualisht përpara dorëzimit në Komisionin e Venecias.
Propozim ndryshimet trajtojnë fushat kritike të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, përfshirë këtu përzgjedhjen, emërimin dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe anëtarëve të Këshillit, si dhe forcimin e transparencës, komunikimit dhe menaxhimit të burimeve në këtë institucion.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji në përputhje me rekomandimet e Misionit të Vlerësimit përbëjnë reformë kyçe për integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut, paraparë në Agjendën e Reformës 2024–2027, si dhe në të gjitha dokumentet e tjera strategjike. Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit do të vazhdojë t'i ofrojë mbështetje teknike dhe këshilluese Ministrisë së Drejtësisë edhe pas marrjes së opinionit nga Komisioni i Venecias, për të siguruar që vendi të zbatojë këtë hap thelbësor reformues që synon rikthimin e besimit në sistemin gjyqësor.



Photos: © Ministry of Justice

Forcimi i procedurave disiplinore për përgjegjshmërinë gjyqësore në Maqedoninë e Veriut

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për të përmirësuar përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në sistemin gjyqësor, projekti "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" organizoi një punëtori mbi procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në Maqedoninë e Veriut. Punëtoria u mbajt më 6–7 maj 2025 në Demir Kapi, duke bashkuar anëtarë të Këshillit Gjyqësor, ekspertë juridikë dhe këshilltarë ndërkombëtarë për të trajtuar sfidat kritike në procedurat disiplinore dhe për t'i harmonizuar ato me standardet evropiane.

Punëtoria u hap me fjalën hyrëse të Gregorz Borkovskit, udhëheqës i komponentit të projektit, i cili theksoi rëndësinë e mekanizmave disiplinorë të drejtë, transparentë dhe efikasë për ruajtjen e integritetit gjyqësor. Në ditën e parë u prezantua ekspertit ndërkombëtar Herman von Hebel, i cili dha një analizë të thelluar të standardeve më të fundit ndërkombëtare dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai nënvizoi nevojën për garantimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të gjyqtarëve, duke ruajtur njëkohësisht parimin e përgjegjshmërisë. Eksperti kombëtar Voislav Stojanovski prezantoi një analizë të procedurave disiplinore të zhvilluara nga Këshilli Gjyqësor gjatë periudhës 2019–2023, duke identifikuar mundësi për përmirësim të mëtejshëm të efikasitetit dhe koherencës në përputhje me praktikat më të mira në zhvillim.



Dita e dytë përfshiu prezantime nga vetë anëtarët e Këshillit Gjyqësor, të cilët shpjeguan çdo fazë të procedurës disiplinore.

Antoaneta Dimovska dhe Tanja Çacarova-Ilievska shpjeguan nisjen e procedurës, rolin e komisionit të referuesve dhe hetimin e rasteve.Vesna Dameva foli për diskutimet brenda komisionit dhe përgatitjen e raporteve hetimore.Ivica Nikolovski prezantoi procesin vendimmarrës të Këshillit Gjyqësor, duke theksuar nevojën për arsyetim të qartë dhe vendimmarrje të qëndrueshme.Selim Ademi analizoi procedurat disiplinore të përsëritura pas ankesave, duke theksuar garancitë procedurale.

Kjo punëtori përbën një moment të rëndësishëm në përpjekjet reformuese të sistemit gjyqësor të Maqedonisë së Veriut, duke forcuar angazhimin e Këshillit Gjyqësor për përgjegjshmëri, efikasitet dhe transparencë. Përmes përmirësimit të procedurave disiplinore në përputhje me standardet evropiane, Këshilli po ndërmerr hapa vendimtarë drejt një gjyqësori të pavarur dhe llogaridhënës, duke forcuar besimin e publikut në sundimin e ligjit.





PRAH ROMAN

INTERVISTË

TA NJOHIM EKIPIN

UDHËHEQËS I KOMPONENTIT

ROMAN PRAH: "LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT ËSHTË NJË PROCES AFATGJATË, NUK KA RECETA TË SHPEJTA"

Njihuni me ekipin: Ky cikël intervistash synon t'ju prezantojë me anëtarët e ekipit të projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", duke i afruar më shumë rolet e personave dhe ekspertizat që qëndrojnë pas zbatimit të këtij projekti të rëndësishëm.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet institucionale dhe për të promovuar qeverisjen e mirë, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me z. Roman Prah, udhëheqës i Komponentit 3 – Përmirësimi i parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit. Z. Prah është një ekspert slloven me mbi 38 vite përvojë në fushat e antikorrupsionit, reformës në drejtësi, administratës publike dhe zhvillimit institucional. Ai ka udhëhequr projekte të shumta të financuara nga BE në të gjithë Ballkanin Perëndimor, përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Turqinë dhe Serbinë. Puna e tij është përqendruar në forcimin e mekanizmave institucionalë për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, me theks të veçantë te transparenca, llogaridhënia dhe standardet etike në institucionet publike.

Së fundmi, z. Prah i është bashkuar ekipit tonë, duke sjellë përvojën e tij të gjerë në zbatimin e aktiviteteve të Komponentit 3. Kjo intervistë është një mundësi për të mësuar më shumë rreth përvojës së tij profesionale, prioriteteve aktuale dhe vizionit për mbështetjen e reformave sistemike nëpërmjet projektit.

Si udhëheqës i Komponentit 3, që fokusohet në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, si e përkufizoni sundimin e ligjit në këtë kontekst?

Nga një këndvështrim juridik, sundimi i ligjit është parimi më i lartë në një demokraci, duke siguruar që të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Sapo keni filluar punën tuaj me ekipin. Cilat janë prioritetet tuaja për muajt në vijim dhe çfarë shpresoni të kontribuoni në arritjen e qëllimeve të projektit?

Së pari, mendoj se roli i Komponentit 3, që punon me përfituesin kryesor — Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) — është të forcojë kapacitetet e tyre në përmbushjen e përgjegjësive të përcaktuara me ligj. Këto përfshijnë deklarimin e pasurisë, promovimin dhe përmirësimin e integritetit, çështjet e konfliktit të interesit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për vlerat morale dhe të integritetit. Kjo është pika numër një.

Objektivi i dytë i rëndësishëm është ofrimi i trajnimeve të përditshme në vendin e punës, të cilat synojnë rishikimin dhe përmirësimin e proceseve institucionale për të siguruar që ato të mbeten efektive dhe të qëndrueshme edhe pas përfundimit të projektit. Mendoj se këto janë dy synimet kryesore të Komponentit 3.

Kur jemi te qëndrueshmëria — nga përvoja juaj, çfarë i bën reformat kundër korrupsionit të qëndrueshme dhe çfarë roli luajnë partneritetet, si ai me KSHPK?

Reformat kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut janë në proces prej disa kohësh. Për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre tani, është thelbësore të vazhdohet mbështetja për KSHPK-në dhe institucionet e tjera kyçe që kontribuojnë në kuadrin kundër korrupsionit.

Qëllimi përfundimtar është të forcohen kapacitetet kombëtare, në mënyrë që, sapo të përfundojë mbështetja e projekteve ndërkombëtare, institucionet në Maqedoninë e Veriut të jenë të pajisura plotësisht për të ruajtur dhe avancuar standardet e integritetit

Partneritetet strategjike, si ai me KSHPK, janë jetike për këtë proces, sepse ato nxisin zotërimin lokal, rrisin qëndrueshmërinë institucionale dhe kontribuojnë në një ndikim afatgjatë e të qëndrueshëm.



Duke pasur parasysh të gjitha këto, cilat janë përbërësit kryesorë për ndërtimin e një sistemi të fortë dhe të besueshëm kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut?

Përbërësi i parë është një kornizë e mirë ligjore. Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, nuk shoh ndonjë dallim të madh në sistemet legjislative. Korniza ligjore kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut është gjerësisht i harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira. Ligji i jep fuqi Komisionit për të promovuar integritetin dhe për të forcuar sistemin e përgjithshëm kundër korrupsionit në vend.

Së dyti, trupat e specializuara apo të pavarura kundër korrupsionit, si KSHPK, kanë nevojë për kapacitete të mjaftueshme. Kur them kapacitete, nuk i referohem vetëm njohurive — niveli i ekspertizës që tregojnë profesionistët atje është vërtet mbresëlënës dhe për t'u lavdëruar. Por gjithashtu nevojitet mjaftueshëm staf për të përballuar detyrat që dalin nga mandati i tyre.

Qeveria duhet të njohë përpjekjet e Komisionit dhe t'i mbështesë ato duke gjetur burime për shtimin e stafit. Ky është një aspekt që duhet të merret seriozisht nga ministritë përkatëse. Çështja e mungesës së stafit është diskutuar prej kohësh. Sigurisht që ekzistojnë kufizime ligjore për rritjen e numrit të të punësuarve në institucionet publike. Ndonjëherë zgjidhja mund të vijë përmes riorganizimit të brendshëm. Kjo është gjithashtu diçka që projekti ua rekomandon palëve tona – përmirësimin e bashkëpunimit ndërdepartamental.

Tani, me zgjedhjet lokale që afrohen, sipas ligjit, fushata zgjedhore fillon tre muaj përpara datës së shpallur. Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave i jep Komisionit një përgjegjësi të madhe për të monitoruar financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore. Ka shumë punë për t'u bërë. Nëse qeveria nuk lejon punësime shtesë, atëherë duhet të shohim se çfarë mund të menaxhohet brenda strukturës ekzistuese. Kjo mund të kërkojë një sistematizim të ri ose një riorganizim të brendshëm, për të siguruar që detyrimet ligjore të përmbushen në kohë dhe me cilësi.

Kur flisni për mbështetjen, si do ta përshkruanit bashkëpunimin tonë me KSHPK-në për dikë që po njihet për herë të parë me projektin tonë? Çfarë lloj mbështetjeje po i ofrojmë institucionit dhe në ç'mënyra po punojmë së bashku për të forcuar rolin e tij?

Kemi ndërtuar një bashkëpunim shumë të sinqertë dhe të bazuar në besim, duke mbajtur komunikim të hapur për qëllimet e projektit dhe mënyrat se si ai mund ta mbështesë Komisionin. Kjo marrëdhënie e mirë bashkëpunimi rezultoi me miratimin e planit tonë të punës, të cilin e diskutuam vetëm dje. Unë e prezantova atë gjatë një takimi me Komisionerët, dhe ata ranë dakord me aktivitetet e planifikuara. Këto aktivitete përputhen me ato që ishin parashikuar në raportin fillestar, megjithëse janë bërë disa modifikime për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të tyre aktuale.

Ne kemi rënë dakord të bashkëpunojmë ngushtë në përgatitjen e Strategjisë së re kundër korrupsionit, e cila është urgjente dhe duhet të finalizohet deri në fund të këtij viti. Një tjetër dokument kyç është strategjia e komunikimit, të cilën do ta zhvillojmë së bashku. Po ashtu, i mbështesim në përgatitjen e një strategjie për TIK dhe në zhvillimin e një zgjidhjeje për sistemin TIK të burimeve njerëzore (HR).

Në përditshmëri bashkëpunojmë me kolegët që merren me deklarimet e pasurisë, me synim përmirësimin e operacioneve të tyre.Për më tepër, planifikojmë të ofrojmë mbështetje eksperte në rishikimin dhe zhvillimin e procedurave operative. Është e rëndësishme që të gjithë të ndjekin të njëjtën qasje në proceset e punës, pasi kjo ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e integritetit të brendshëm, si dhe në ndërtimin e mekanizmave të monitorimit, të domosdoshëm për çdo institucion serioz.

Lufta kundër korrupsionit mund të jetë një sfidë afatgjatë. Çfarë ju motivon personalisht në këtë fushë dhe çfarë ju jep shpresë për përparim real në Maqedoninë e Veriut?

Çfarë më motivon? Bindja se çdo gjë është e mundur—nëse duam ta bëjmë. Jam vërtet optimist për përparim të vërtetë.
Maqedonia e Veriut ka qenë, në fakt, një nga vendet e para në Ballkan që ka nisur përpjekje të institucionalizuara kundër korrupsionit. Komisioni i parë, besoj, është themeluar në vitin 2002. Që atëherë, janë bërë shumë gjëra—me ngritje dhe ulje, gjë që është normale për çdo vend apo sistem. Ajo që është jetike tani është që angazhimi politik të përkthehet në veprime konkrete që çojnë përpara reformat kundër korrupsionit.

Shpesh dëgjojmë se “duhet vullnet politik” për të luftuar korrupsionin, por shumë herë kjo mbetet thjesht një frazë. Ajo që duhet janë hapat konkretë. Një hap i rëndësishëm është hartimi i ndryshimeve në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave.

Megjithatë, Komisioni nuk mund të mbajë i vetëm përgjegjësinë për përparimin e sistemit kundër korrupsionit. Duhet të ekzistojë një sistem i tërë funksional. Komisioni është vetëm një pjesë e mozaikut. Siç them shpesh: një kalë nuk mund të tërheqë i vetëm një karrocë të ngarkuar rëndë—duhet përpjekje e përbashkët.

Komisioni po punon për të forcuar bashkëpunimin me partnerët, veçanërisht me sektorin civil, dhe nëpërmjet tyre, për të arritur tek qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Në fund të ditës, mbështetja politike do të jetë e nevojshme gjithashtu. Nuk mund ta anashkalojmë rolin e politikës. Edhe politikanët duhet të forcojnë kapacitetet e tyre në këtë drejtim. Kur krahasoj vendet e rajonit, ato përballen me sfida të ngjashme: korrupsioni, prokurimi publik, gjyqësori, arsimi dhe shëndetësia. Lufta kundër korrupsionit është një sfidë e gjatë që kërkon angazhim të vazhdueshëm, qëndrueshmëri institucionale dhe veprim të koordinuar në të gjitha sektorët. Nuk zgjidhet brenda natës. Nuk ka recetë të shpejtë.

Kështu, gjithmonë kthehemi tek bazat: përpjekjet e qëndrueshme kundër korrupsionit mbështeten në kornizeë të fortë ligjor, profesionistë të përkushtuar—kampionë të integritetit—dhe në mbështetjen aktive të qytetarëve të informuar dhe të angazhuar. Në fund të fundit, janë vetë qytetarët që përfitojnë nga politika efektive kundër korrupsionit.
Jam i bindur se projekti ynë do të arrijë rezultate të qëndrueshme në Maqedoninë e Veriut.



MAJ – GUSHT 2025

KALENDARI I AKTIVITETEVE TË ARDHSHME

22 MAJ

Promovimi i Raportit Vjetor për Zbatimin e Strategjisë për Drejtësi (2024 – 2028), për vitin 2024

Komponenti 1

QERS HOR

Konferencë për Procedurat Disiplinore ndaj Gjyqtarëve me Anëtarët e Këshillit Gjyqësor

Komponenti 1

17 QERS HOR

Trajnim për Dokumentimin e Lëndimeve – i dedikuar për MNP (Mekanizmin Parandalues Kombëtar) dhe Departamentet për Punë të Brendshme – Tetovë & Kumanovë

Komponenti 4

08 KORRIK

Bisedat e Barazisë (Equality Talks) #2: E drejta për strehim për romët

Komponenti 4

Informacion publikimi (shtypje)

BOTUES:
Ludwig Boltzmann Gesellschaft – Instituti për të Drejtat Themelore të Njeriut (LBI-GMR), Vjenë, në kuadër të projektit "Mbështetje e BE-së për sundimin e ligjit", Shkup
REDAKTORE: Kristina Vesikj
KORRektor: Ane Petrushevska
Periudha e raportimit: 08 shkurt – 07 maj 2025
Data: 07 maj 2025

Financuar nga Bashkimi Evropian